

## Për më shumë informacion:

<https://akrbnl.inca-al.org/sq/>

Adresa: Rruga Islam Alla,  
Pallati IVEA, kat. Ire, Tiranë

Tel/Fax: +355 42231437

[www.inca-al.org](http://www.inca-al.org)

e-mail: [info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org)



Projekti zbatohet nga:  
Partneri drejtues i projektit:  
Instituti per Ruajtjen e Natyres ne Shqiperi



### Shoqatat partnere:



Klubi Ekologjik, Lezhë - KEL



Mbrojtja e Mjedisit dhe  
Zhvillimi i Turizmit , Has - MMZhT




Shoqata "Horizont EU", Lushnje

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Ky botim u realizua me mbështetjen e LevizAlbania.  
Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe  
nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e LevizAlbania



## RRJETËZIMI DHE ADVOKIM

PËR AKSIONE KOMUNITARE  
TË **RUAJTJES** SË BURIMEVE  
NATYRORE **LOKALE**



Ky projekt zbatohet me mbështetjen financiare të  
LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane  
për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

## Koncepti i projektit:

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në vendin tonë nuk është ende i integruar si duhet në politikat kombëtare dhe veçanërisht në ato lokale. Mospërfshirja e komunitetit dhe OSHC në vendimmarrjet lokale vjen përgjithësisht si pasojë e kapaciteteve të ulëta dhe mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal dhe mungesës së koordinimit midis organizatave të shoqërisë civile që i përfaqësojnë. Nga ana tjetër komunitetet lokale nuk janë të mirë informuara mbi mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore si potenciale për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre. Aktualisht, kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikave lokale të ruajtjes së mjedisit dhe natyrës duke sjellë menaxhim jo të mirë të burimeve natyrore. Fuqizimi i zërit qytetar përmes rrjetëzimit të OSHC-ve lokale dhe kombëtare mbetet një nga sfidat për përmirësimin e demokracisë së brishtë dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe kombëtar.

### Qëllimi:

Te kontribuojmë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe kombëtar

## Objektivat:

- Të nxisë rrjetëzime kombëtare dhe lokale aktive të OSHC-ve për ruajtjen e natyrës dhe partneritetin e tyre në programe pune afatgjatë advokimi për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Të rrisë angazhimin qytetar/komunitar dhe mediatik në aktivitetet advokuese të OSHC-ve për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore lokale, duke përdorur të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje mbi procesin e zbatimit të politikave dhe vendimmarrjes që ndikon në burimet natyrore lokale.

## Rezultatet e pritshme:

- Konsolidim dhe profesionalizëm të organizatave të rrjetit për mbrojtjen e natyrës dhe kualifikimit të stafit të OSHC-ve lokale nëpërmjet informimit dhe shkëmbimeve të eksperiencave
- Forcimi i bashkëpunimit me organet e institucioneve vendore në tre zonat pilote për menaxhimin e qëndrueshëm të vlerave natyrore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm lokal;
- Pjesëmarrje në forume të ndryshme vendimmarrëse apo këshillimore duke synuar përmirësimin e vendimmarrjes lokale për përdorimin e burimeve natyrore mbështetur në planet vendore të zhvillimit.
- Rritje e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përcaktimi më i mirë i rolit të gjithë aktorëve në nivel vendor në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve vendore të mjedisit përmes procesit të transparencës dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.
- Përmirësimi i procesit të informimit dhe rritjes së njohurive të publikut mbi vlerat e natyrës dhe rëndësinë e një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore me mbështetjen e mediave.

## Përfituesit

- Shoqëria shqiptare, veçanërisht komunitetet lokale: Ky veprim do të mundësojë që shoqëria të jetë më aktive dhe pjesëmarrëse në proceset e vendimmarrjes, zhvillimin e politikave në nivel vendor dhe zbatimin e ligjit në nivel lokal.
- Sektori i OSHC-ve shqiptare duke përfshirë OMSHC-të: Veprimi do të përmirësojë strukturat dhe mekanizmat e duhur për bashkëpunimin e OSHC-ve me institucionet publike, si dhe flukse të lira, të qarta dhe të arritshme të informacionit për çështje me interes publik.
- Institucionet vendore - janë institucione publike lokale që janë në përmirësim të strukturave të tyre organizative në funksion të zbatimit të ligjit të vetëqeverisjes vendore. Ky veprim do t'i japë mundësi institucioneve vendore të rritin njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të zbatimit të legjislativitetit respektiv duke kuptuar më në detaje përgjegjësitë dhe rritur nivelin e bashkëpunimit me komunitetin për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të zhvillimit.

